



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 1148/3 prot.

Tiranë, më 14.07.2025

Vendim

Nr. 42 datë 14.07.2025

Për disa avancime në titullin akademik; për zgjedhjen e një anëtari të ri të Asamblesë me titullin akademik, në fushën e historisë; zgjedhjen e një anëtari të ri të jashtëm dhe pranimi i një anëtari të ri nderi, të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Asambleja e Akademisë së Shkencave, e mbledhur më datën 14 korrik 2025, me rend dite sipas vendimit të Kryesisë nr. 35, datë 19.06.2025 “Për thirrjen e mbledhjes së Asamblesë së Akademisë së Shkencave”, bashkëlidhur, kreu procedurat e parashikuara në nenet 6 dhe 11 të ligjit “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 7, 10 dhe 11 dhe Aneksit 2 dhe 3 të Statutit, për zgjedhjen e anëtarëve të rinj me titullin akademik, anëtar i jashtëm dhe anëtar nderi i ASH-së.

Pasi konstatoi se konkurrimi i kandidatëve është bërë në përputhje me të gjitha procedurat e parashikuara në ligjin nr. 53/2019 sipërcituar dhe në kriteret specifike dhe procedurat e vlerësimit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë, anëtar i jashtëm dhe anëtar nderi, të Akademisë, përcaktuar në Aneksin 2 dhe 3 të Statutit të Akademisë; si dhe pasi u bë paraqitja e kandidaturave nga Kryetari i Akademisë, Asambleja zgjodhi komisionin e votimit për administrimin statutor të procesit zgjedhor, me këtë përbërje: akad. Anila Hoda, kryetare; akad. Rajmonda Bualjoti, anëtare dhe akad. Marenglen Verli, anëtar.

Referuar rezultatit të shpallur prej komisionit të zgjedhjeve pas përfundimit të votimit (procesverbali bashkëngjitur), Asambleja, në bazë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:

Vendosi:

1. Fitojnë titullin akademik anëtarët e Asamblesë me titull të mëparshëm akademik i asociuar:

- Besnik Baraj
- Gëzim Hoxha
- Stefan Çapaliku

2. Zgjidhet anëtar i Asamblesë duke fituar titullin *akademik*, në shkencën e historisë:

- Hamit Kaba

3. Zgjidhet *anëtar i jashtëm* i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

- David Kalaj

4. Pranohet *anëtar nderi* i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë:

- Melissa J. Perry

5. Ceremonia e dorëzimit të diplomave të bëhet me solemnitetin e parashikuar në Rregulloren për ceremonialin në Akademinë e Shkencave.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: kryesia, kancelari, sektori i buxhetit dhe i financës dhe specialisti i burimeve njerëzore dhe jurist.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

